



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 65
Prishtinë, më 14 qershor 2012

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 14 QERSHOR 2012**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Sabri HAMITI**, nënkryetar i Kuvendit

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 72 deputetë dhe i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare.

Kryetari procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Aurora Bakalli, Arben Gashi, Shaip Muja, Liburn Aliu, Emin Gërbeshi, Kymete Bajraktari, Duda Balje, Arsim Bajrami dhe Vjosa Osmani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Kymete Bytyçi parashtrroi pyetje për ministrin Mahir Yagcilar në lidhje me nxjerrjen e legjislacionit sekondar të Shërbimit Civil të Kosovës.

Ministri Mahir Yagcilar iu përgjigj pyetjes së deputetes Kymete Bytyçi.

Deputetja Time Kadrijaj parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me masat që mund t'i ndërmarre Ministria që ai drejton ndaj drejtorit të QKUK-së, për shkak të pushimit të tij në Turqi, me donacion të një kompanie farmaceutike të quajtur "Altupharm".

Ministri Ferid Agani nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Goran Marinković parashtroi pyetje për ministrin Nenad Rashić në lidhje me numrin e projekteve të realizuara nga Ministria që ai drejton në komunat me popullatë shumicë serbe.

Ministri Nenad Rashić iu përgjigj pyetjes së deputetit Goran Marinković.

Deputetja Nazane Breca parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me shpjegimet që mund t'i ketë ai për shkak të pushimit të drejtorit të QKUK-së, në Turqi, me donacion të një kompanie farmaceutike të quajtur "Altupharm".

Ministri Ferid Agani nuk ishte i pranishëm në sallë.

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të mbajtura më 1 dhe 7 qershor 2012

Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 1 dhe 7 qershor 2012.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër

Kryetari i njoftoi deputetët se në mbledhjen plenare, të mbajtur më 7 qershor 2012, Kuvendi ka proceduar votimin e tetë (8) amendamenteve në Projektligjin për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër.

Ai tha se për shkak të dallimeve që kishin, Komisioni Funkcional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, për nivelin e kompensimit për kategoritë që përfshin ky projektligj në amendamentin nr. 9, Kuvendi në mbledhjen e kaluar i ngarkoi dy komisionet e lartpërmendura që t'i harmonizojnë qëndrimet e tyre.

Qëndrimet e harmonizuara, në emër të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione i paraqiti deputetja Suzan Novoberdaliu. Ajo tha se jemi pajtuar që për amendamentin nr. 9 të mbetet vetëm propozimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa, ndërsa amendamenti nr. 22 të tërhiqet, si propozim.

Më tej deputetja Suzan Novoberdaliu propozoi që në tekstin e këtij projektligji, në vend të fjalës "pension" të përdoret fjala "kompensim".

Kryetari kërkoi që deputetët nëpërmjet votimit formal të deklarohen për propozimin që në tekstin e projektligjit, në vend të fjalës "pension" të përdoret fjala "kompensim".

Kuvendi miratoi propozimin e lartpërmendur.

Diskutimi i deputetes Suzan Novoberdaliu është dhënë i plotë në transkript.

Kryetari pastaj i hodhi në votim amendamentet veç e veç, duke filluar nga amendamenti nr. 9 - propozim i Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 23, 24, dhe 25.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 56,
Kundër ----- 8,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për personat e verbër.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL Raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa e paraqiti deputetja Safete Hadërgjonaj.

Për këtë pikë të rendit ditës diskutuan edhe deputetët: Arben Gashi - në emër të Komisionit për Legjislacion, Visar Ymeri - në emër të GP të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Safete Hadërgjonaj, Arsim Bajrami dhe Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 60,
Kundër----- 8,
Abstenime----- 6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-221.

Kryetari i deklaroi të mbyllura punimet e mbledhjes plenare në orën 11:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale